

# DOKUMENT POLITIKASH

## Reforma Administrative-Territoriale 2026 Perspektiva e Shoqërisë Civile – Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike” (POP) Drejt një reforme të orientuar nga qytetari, demokracia vendore dhe kohezioni territorial

**Qëllimi:** Të orientojë vendimmarrjen drejt një reforme funksionale, të bazuar në evidencë, me legjitimitet demokratik dhe ndikim real në cilësinë e shërbimeve dhe barazinë territoriale.

### Mesazhi kryesor

Suksesi i Reformës Administrative - Territoriale 2026 nuk matet nga ndryshimi i hartës administrative, por nga përmirësimi i jetës së qytetarëve.

### Prioriteti duhet të jetë:

- funksionimi dhe performanca e qeverisjes vendore;
- cilësia dhe barazia e shërbimeve;
- afërsia me vendimmarrjen;
- transparenca dhe besimi publik.

Ndryshimet e kufijve territorialë duhet të konsiderohen vetëm si opsion i fundit, kur evidenca demonstroi qartë domosdoshmëri dhe kur komunitetet e prekura e mbeshtesin ndryshimin gjatë proceseve konsultative ose përmes një referendum vendor konsultativ.

### Mësime nga zbatimi i Reformës Administrative - Territoriale 2014

#### Çfarë funksionoi:

- Konsolidim institucional dhe rritje e specializimit administrativ.
- Kapacitete më të mira për projekte dhe investime (sidomos në bashkitë urbane).
- Formalizim i transparencës dhe publikimit të informacionit.
- Rritje e përfaqësimit numerik të grave në këshillat bashkiakë.

#### Çfarë nuk funksionoi (ose pjesërisht):

- Rritje e distancës qytetar-vendimmarrje.
- Dobësim funksional i njësive administrative.
- Pjesëmarrje qytetare kryesisht formale.
- Pabarazi territoriale në investime dhe shërbime.
- Përfaqësimi i grave jo gjithmonë me ndikim real në financa dhe prioritetet zhvillimore.

## Problemet kryesore që Reforma 2026 duhet të adresojë

Reforma Administrative- Territoriale 2014 solli përmirësime në kapacitetet administrative, por la të pazgjidhura disa dobësi strukturore që ndikojnë drejtpërdrejt në demokracinë vendore dhe barazinë territoriale.

Bazuar në monitorimin e Rrjetit POP (2019–2025) dhe në standardet e BE/SIGMA, **Reforma 2026 duhet të adresojë:**

- Distancën mes qytetarëve dhe vendimmarrjes, veçanërisht në zonat rurale dhe periferike.
- Dobësimin funksional të Njësive Administrative, me rol të kufizuar në planifikim dhe prioritizim lokal.
- Rolin e dobësuar të Këshillave Bashkiakë, shpesh të kufizuar në miratim formal të vendimeve të ekzekutivit.
- Pjesëmarrjen qytetare kryesisht formale, me ndikim të ulët real në vendimmarrje.
- Pabarazitë territoriale në investime dhe shërbime, brenda dhe ndërmjet bashkive.
- Kapacitetet fiskale dhe administrative të pabarabarta, që kufizojnë zhvillimin e balancuar.

### Dimensioni gjinor dhe social: matësi i suksesit të Reformës Administrative-Territoriale.

- Reforma administrative - territoriale nuk është vetëm riorganizim administrativ; ajo ndikon drejtpërdrejt në jetën e grave dhe grupeve më të cënueshme. Ndryshimet territoriale prekin aksesin në shërbime sociale dhe kujdes, transportin, sigurinë publike dhe mundësinë reale për pjesëmarrje në vendimmarrje.
- Centralizimi i proceseve dhe dobësimi i Njësive Administrative kanë ndikim disproporcional për gratë, veçanërisht në zonat rurale, për shkak të barrës së kujdesit, kufizimeve kohore dhe vështirësive të transportit.
- Pa një qasje territoriale dhe gjinore, pabarazitë në investime dhe shërbime përkthehen në pabarazi reale në siguri, akses ekonomik dhe përfaqësim. Një reformë cilësore matet nga ndikimi i saj në barazinë gjinore dhe kohezionin social.

*Reforma 2026 duhet të ruajë përfitimet e konsolidimit, por të korrigjojë këto dobësi për të forcuar demokracinë vendore dhe për të garantuar rezultate të barabarta për qytetarët.*

## Kërkesa strategjike e Rrjetit POP

Çdo ndryshim i kufijve territorialë duhet të konsiderohet i ligjshëm dhe i qëndrueshëm vetëm nëse plotësohen këto kushte:

- evidenca demonstroi qartë nevojën reale për ndërhyrje;
- është kryer një vlerësim i plotë ndikimi (fiskal, administrativ, social dhe gjinor);
- komunitetet e prekura e miratojnë ndryshimin përmes një referendumi vendor konsultativ.

Nëse referendumi vendor konsultativ nuk mbështet ndryshimin e propozuar, rezultati duhet të merret seriozisht në konsideratë dhe të peshohet si element thelbësor në vendimmarrje. Në këto raste, prioritet duhet t'u jepet masave funksionale, financiare dhe institucionale për adresimin e problemeve, përpara se të procedohet me ndryshime kufijsh.

### Ky standard mbështetet në:

- Nenin 108/2 të Kushtetutës ("marrja e mendimit të popullsisë");
- Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore (neni 5);
- parimet e BE/SIGMA për legjitimitet demokratik, proporcionalitet dhe besim publik.

## Kushtet minimale para çdo vendimi për ndryshim kufijsh

Para çdo vendimi për ndryshim të kufijve territorialë, Kuvendi i Shqipërisë duhet të kërkojë:

- Vlerësim ex post të Reformës 2014, me fokus në rezultatet reale për qytetarët (akses, cilësi shërbimesh, barazi territoriale).
- Vlerësim të plotë ndikimi për çdo alternativë, duke analizuar dimensionin fiskal, administrativ, social, territorial dhe gjinor.
- Analizë ex post të zbatimit të ligjit nr. 119/2014 (e drejta për informim) dhe ligjit nr. 146/2014 (njoftimi dhe konsultimi publik) në nivel vendor.
- Konsultim të hershëm, të dokumentuar dhe gjithëpërfshirës me komunitetet dhe njësitë e prekura.
- Transparencë të plotë mbi alternativat, kostot dhe pasojat e tranzicionit.
- Vendosjen e një sistemi kombëtar për monitorimin e performancës vendore, me tregues të matshëm.
- Referendum vendor konsultativ në territoret e prekura, si mekanizëm për garantimin e legjitimitetit demokratik.

## Sugjerime nga Rrjeti POP: 8 masa prioritare për Reformën Administrative - Territoriale 2026

1. Fuqizim real i Njësive Administrative (kompetenca, burime, rol në planifikim), me qëllim ofrimin e shërbimeve sa me afër qytetarit
2. Standarde minimale kombëtare për shërbimet bazë (kujdes social, transport lokal, siguri).
3. Raportim i detyrueshëm territorial i investimeve brenda bashkisë.
4. Mekanizma më të fortë të barazimit fiskal dhe mbështetje për bashkitë me kapacitete të ulëta.
5. Forcim i rolit të Këshillave Bashkiakë si organ mbikëqyrës dhe garant i barazisë territoriale. Matje periodike e kënaqësisë së qytetarëve dhe përdorimi i saj në buxhetim.
6. Konsultim publik i standardizuar me feedback të detyrueshëm.
7. Integrim i perspektivës gjinore në planifikim dhe buxhetim (të dhëna të ndara sipas gjinisë, hapa drejt GRB).
8. Garanci demokratike për ndryshimet territoriale: transparencë, konsultim dhe referendum vendor.

### Thirrje për veprim

Reforma Administrative - Territoriale 2026 është një reformë e besimit publik dhe e cilësisë së qeverisjes – jo vetëm e hartës administrative. Për të qenë e qëndrueshme dhe legjitime, ajo duhet të:

- vendosë qytetarin në qendër,
- reduktojë pabarazitë territoriale dhe sociale,
- përmirësojë cilësinë e shërbimeve,
- integrojë barazinë gjinore,
- të garantojë legjitimitet demokratik për çdo ndryshim territorial përmes referendumit vendor konsultativ.

## Kush është Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”

---

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP” është një iniciativë kombëtare e organizatave të shoqërisë civile shqiptare, që synon të forcojë demokracinë vendore dhe debatin publik përmes rritjes së transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes qytetare. POP punon për të orientuar platformat politike dhe vendimmarrjen publike drejt nevojave dhe prioriteteve reale të qytetarëve, duke nxitur një kulturë qeverisjeje të bazuar në evidencë dhe dialog.

Rrjeti mbështetet nga Qeveria Suedeze nëpërmes “Olof Palme International Center”, dhe National Endowment for Democracy.

### Anëtarët e Rrjetit POP:

---

- Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër
- Qendra Rinore Vlorë
- Epoka e Re, Fier
- Tjetër Vizion, Elbasan
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë
- Qendra për Progres Rinor, Kukës
- Gruaja në Zhvillim, Korçë
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës

### Kontrata Sociale

---

Kontrata Sociale është mekanizmi kryesor i monitorimit dhe dialogut qytetar i zhvilluar nga Rrjeti POP për forcimin e qeverisjes vendore.

#### Ajo funksionon përmes:

- identifikimit të prioriteteve të komunitetit përmes grupeve të fokusuar dhe konsultimeve publike para zgjedhjeve vendore;
- përkthimit të këtyre prioriteteve në angazhime konkrete të autoriteteve vendore;
- monitorimit sistematik të përmbushjes së angazhimeve gjatë mandatit përmes analizës së dokumenteve strategjike dhe buxhetore;
- organizimit të forumeve qytetare dhe aktiviteteve advokuese për rritjen e llogaridhënies.

**Kontrata Sociale** shërben si instrument për matjen e performancës së qeverisjes vendore dhe si mekanizëm për orientimin e politikave dhe investimeve drejt nevojave reale të komunitetit, në përputhje me standardet e qeverisjes së mirë dhe demokracisë vendore.

### Lexoni dokumentin e plotë

Skano kodin QR për ta aksesuar online

